



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:120938

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06435499

PKR.nr.194/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarit B.R., i akuzuar për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.83/2024, të datës 17.10.2024, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 06.11.2024, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit Fatmire Cacaj dhe i akuzuari B.R., me mbrojtësen e tij av. Mevlyde Qerimi e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 07.11.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.R., i biri i K. dhe Z., e vajzërisë B., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna Lipjan, rr.", "...", pa numër, me numër personal ..., ka të kryer Shkollën e Mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: me datë 19.04.2024, rreth orës 18:40, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, saktësisht te rrethi i J., me qëllim të shitjes, shpërndarjes ose ofrimit për shitje, me dashje ka blerë edhe ka poseduar pa autorizim, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që, policia pasi ka ndaluar veturën "Mercedes", ngjyrë e zezë, me targa ... në të cilën i pandehuri ishte pasagjer, pas kontrollimit të veturës, te ndërruesi i shpejtësisë është gjetur një gjysmë cigare e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit Marihuanë me peshë 0.4 gram, ndërsa gjatë kontrollit të personave, te i pandehuri B., përkatësisht në çantën e tij të krahut janë gjetur 12 qese të vogla të mbushura me substancë të dyshuar narkotike e llojit Marihuanë me peshë 16.1 gram, të gatshme për shitje, 15 paketime të vogla me peshë 9 gram të gjetura brenda në deodorantin AXE në çantën e krahut, një telefon celular dhe para të gatshme në valuta të ndryshme në vlerë 270 euro, që dyshohet se janë përfituar nga shitja e narkotikëve, ndërsa në shtëpinë e të pandehurit policia ka gjetur dy kavanoza qelqi të mbushura me narkotikë me peshë 30.9 gram, një qese e vogël e mbushur me narkotikë me peshë 2.5 gram dhe një pako me qese të zbrazura që shërbejnë për paketimin e narkotikëve në sasi të vogla, me ç rast sipas raportit të ekspertimit forenzik dëshmitë e lartcekura

sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike, përmbajnë Kanabis (Marihuanë) përkatësisht Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto të përgjithshme 31.58 ± 0.0001 gram, $13.58, \pm 0.0001$ gram dhe 7.96 ± 0.0001 gram, të cilat policia i ka sekuestruar sipas vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 2; 17; 21; 38; 42; 43; 69; 70; 71; 72, par. 1, nënpar. 1.4; 267 par. 1 dhe 5 të KPRK si dhe neneve 277 e 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM

- **Dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1000) €, dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti**, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Dënimin me gjobë si më lart, i akuzuari mund ta paguaj deri në tri këste.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'i caktoj të dënuarit një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- **Nga i akuzuari B.R., konfiskohen: para në shumë prej 270 euro të përfituara me kryerjen e veprës penale dhe një telefon celular i llojit Iphone 15 pro max, i përdorur për kryerjen e veprës penale, e po ashtu konfiskohet dhe shkatërrohet apo asgjësohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 53.12 gram, e përdorur për kryerjen e veprës penale.**
- Urdhërohet që paratë e konfiskuara si më lart dhe telefoni celular i llojit Iphone 15 pro max, të mbahen në shfrytëzim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ose telefoni të shitet dhe paratë nga shitja kalojnë në buxhetin e shtetit, e nëse asnjëra nga këto mundësi nuk mund të zbatohet, atëherë telefoni celular të shkatërrohet.
- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj **shumën prej pesëdhjetë (50) €, si dhe pesëdhjetë (50) € për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë / Sektori Rajonal në Prishtinë nr. R-2024-XI-DKKO-HTN-PR-49, të datës 20.04.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.83/2024, të datës 17.10.2024, ka akuzuar të pandehurin B.R., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 06.11.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari B.R. është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se është penduar për veprën penale dhe nuk do ta përsërisë më, si dhe i ka propozuar gjykatës të këtë parasysh se jeton në Lipjan në banesë me qira vetëm me

nënën pasi prindërit i ka të ndarë dhe se qiranë e paguan vëllai i tij i cili punon jashtë vendit dhe siguron ekzistencën e tyre materiale pasi që ai dhe nëna e tij janë të pa punë.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari sepse pranimi i fajësisë është bërë më vullnetin e plotë të tij, konform dispozitave ligjore dhe konform gjendjes faktike të përshkruar në aktakuzë, përkatësisht në provat materiale dhe personale, si dhe ka propozuar që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe të marr parasysht rrethanat e paraqitura në aktakuzë në faqen e tretë të saj, ndërsa substancat narkotike të konfiskohen.

Edhe mbrojtësja e të akuzuarit ka deklaruar se e mbështet deklarin e të mbrojturit të saj dhe i ka propozuar gjykatës që para se të merr vendim lidhur me caktimin e dënimit të merr për bazë rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë gjatë gjithë procedurës penale, shprehjen e keqardhjes, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale dhe moshën e re të tij.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pranimit të fajësisë nga i akuzuari B.R., kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i njëjti, pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se ky pranim u bë vullnetarisht pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, se ky pranim nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimit apo premtimit si dhe u mbështet në faktet që përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu, edhe nga provat materiale të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, përkatësisht: Raporti i ekspertimit të narkotikëve nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, numër Lab. AKF/2024-1755/24-1622 i datës 18.06.2024; Raporti i ekspertimit të narkotikëve nga AKF me numër La. AKF/2024-1906/24-1810 i datës 26.07.2024; Raporti përcjellës me raportin e ekspertimit lidhur me ekzaminimin e telefonit mobil i lëshuar nga AKF, i datës 22.05.2024; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; procesverbali mbi kontrollimin e shtëpisë i datës 19.04.2024 dhe Foto dokumentacioni i sendeve të sekuestruara të gjetura te i akuzuari, e në veçanti në bisedat nga i dyshuari në rrjetin social facebook, ku një person i referohet me fjalët “ a mun kryen pun ni 5” dhe në një rast e pyet “ a ka naj joint të tokës”, e ku i pandehuri i thotë ”sa dush veç a kie pare” si dhe videot ku shihen substancat narkotike në sasi të mëdha e të cilat video kanë mbishkrime të ndryshme si “ New fresh indor”, “ njihuni me majën e lules”, “ Bujrum bablokat e mi”, video të cilat i pandehuri i ka shpërndarë në rrejte sociale në mënyrë që t’i njoftonte përdoruesit se posedon narkotik për shitje, e me të gjitha këto vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kështu që, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit si më lart ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si më lart, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pastaj të akuzuarin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysht të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë rrethanën lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës dhe moshën e tij relativisht të re propozimi në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht i njëjti dy muaj pasi ka mbushur moshën 23 vjeçare ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari B.R., është proceduar penalisht me aktgjykimin P.nr.633/2019 neni 269 KPRK, i dënuar me 200 euro gjobë, i plotfuqishëm me 19.11.2020, derisa rrethanë të tillë e ka marrë parasysht edhe shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, sepse me vënien në qarkullim të narkotikëve të rrezikshëm rrezikohet shëndeti dhe jeta e qytetarëve të cilët konsumojnë këto substanca.

Andaj, gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohen sendet – substancat narkotike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, u mor në bazë të dispozitës së nenit 267, par. 5 të KPRK, pasi që të njëjtat janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të neneve 267 par. 1 dhe 5 të KPRK, si dhe nenit 364 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 11.11.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.194/2024, datë 07.11.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.